



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:042080
Datë: 23.01.2024
Numri i dokumentit: 05225812

C-IV-21-0080

Parashtruesi i Ankesës

A T, Prizren

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (N.SH “Dardania” në Likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 23 janar 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit aprovohet si e bazuar.**
- 2. Shfuqizohet Aktvendimi i autoritetit të likuidimit PRZ038-0027 datë 9 shtator 2013.**
- 3. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankuesit A T, që në emër të kompensimit të tre (3) pagave të papaguara, ti paguhet shuma prej 882.36 Euro.**
- 4. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 14 tetor 2013, ankuesi parashtror kërkesë për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëposhtëm AL) PRZ038-0027 datë 9 shtator 2013, (në tekstin e mëposhtëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim e tri (3) pagave të papaguara në shumë prej 882.36 (tetë tetë dy tre gjashtë) Euro nga N.SH. “Dardania” (në Likuidim).

Ankuesi, ndër të tjerash pohon se, AL me rastin e shqyrtimit të kërkesës kreditore, gabimisht ka aplikuar dispozitat ligjore, si ajo të Ligjit për punën e bashkuar (LPB) dhe Ligjit për AKP (shtojca e ligjit), dhe se AKP nuk ka marr në konsiderim dhe nuk ka aplikuar dispozitat e ligjeve, si ato për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim, Rregulloren e UNMIK-ut mbi shoqëritë tregtare, Ligjin e punës dhe Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve.

Nga gjitha arsyet kërkon nga gjykata marrjen e një vendimi të drejtë me rastin e shqyrtimit të kërkesës-ankesës.

Kërkesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e kërkesës kreditore, e datës 8 korrik 2013,
- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e Njoftimit lëshuar nga ana e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM), e datës 11 korrik 2007. Sipas këtij njoftimi shihet se ankuesi i është ndërprerë marrëdhënia e punës duke filluar nga data e lëshimit, si rezultat i shitjes përmes tenderit dhe se pagat – shumat e papaguara do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit (në tekstin e mëtutjeshëm NJOFTIMI),
- Kopja e Aktvendimit, e datës 1 gusht 2000, mbi caktimin e punëtorit për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës,
- Kopjet e listës së pagave të punëtorëve të NSH, datë 21 qershor 2007, drejtuar AKM – Zyrës Regjionale Prizren, për periudhën janar gjer qershor 2007, i cili përmban edhe emrin e ankuesit (nr. rendor 2) (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE 1),
- Kopja e listës së punëtorëve të NSH, drejtuar AKM, i cili përmban emrin e ankuesit (nr. rendor 3) (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE 2),
- Kopja e vërtetimit, lëshuar nga NSH., e datës 10 korrik 2007, në të cilin thuhet se ankuesi ka punuar pranë NSH gjer me 11 korrik 2007 (në tekstin në vijim VËRTETIMI),
- Kopja e Librezës së punës, për ankuesin, dhe
- Kopja e Vendimit të AL, PRZ041-0151 datë 25 shtator 2013, PRZ-041-0105 datë 25 shtator 2013 dhe PRZ041-0135 datë 25 shtator 2013, për A S.

Me 20 shkurt 2014, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin nga i cili u kërkua që të parashtroj kopjen e autorizimit për përfaqësuesin e tij ligjor i cili duhet të jetë anëtar i Odës së Avokatëve dhe përkthimin në gjuhën Angleze të ankesës dhe parashtresave mbështetëse.

Bazuar në urdhrin e lartcekur, me 13 mars 2013, ankuesi parashtroj një parashtresë me të cilin kërkoi ndihmë në përkthim. Parashtresës i janë bashkangjitur dokumentacioni mbështetëse.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, ankuesi parashtroj formën e kërkuar mbi ndihmën në përkthim dhe lirim nga pagesa e taksave gjyqësore. Kërkesës i janë bashkangjitur kopje të dokumentacioneve në mbështetje të kërkesës.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 11 korrik 2014, parashtroj mbrojtjen.

AKP pohon se kërkesa është e pabazuar. AKP konsideron se AL ka bërë një vlerësim të saktë dhe se dispozitat ligjore i ka zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP pohon se Ligji i punës së bashkuar – LPB është i zbatueshëm gjersa Ligji i punës 03/L-212 nuk mund të zbatohet në procedurë të likuidimit. AKP i referohet vendimeve të DHPGJS. AKP përfundimisht pohoj se kërkesa kreditore e ankuesit është e parashkruar. Nga gjitha arsyet propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur kopja e Vendimi për fillimin e procedurës së Likuidimit të NSH dhe emërimin e anëtarëve të AL.

Përgjigja e AKP ju dorëzua ankuesit me 4 gusht 2014.

Nuk u parashtrua përgjigje.

Gjykata me Aktvendimin C-IV-13-2319 datë 14 shtator 2020 aprovoj kërkesën e ankuesit, shfuqizoj Vendimin e AL dhe obligoj AL që kërkesën kreditore ta rishqyrtoj.

Kolegji i Apelit i DHPGJS (KA), me Aktvendimin e saj AC-I-20-0468 datë 2 korrik 2021, aprovoj ankesën e AKP dhe anuloi Aktvendimin e gjykatës datë 14 shtator 2020.

KA në arsyetimin e vendimit, theksoj që gjykata duhet të vendos vet në meritat e ankesës së ankuesit.

Me 22 qershor 2023, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin me të cilin ju kërkua fakte dhe prova plotësuese në mbështetje të kërkesës.

Urdhri nuk është përmbushur.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit (nr. 06/L-086) për DHPGJS, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata konsideron se lidhur kompensimin, parashihet se si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozita e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar, duke u kufizuar në tri paga bruto,
- b. Marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i Vendimit të AKP, dhe
- c. Ndonjë veprimi tjetër nga ana e Agjencionit, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast ankuesi ka ofruar dëshmi relevante që dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të tij dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të AKP.

NJOFTIMI, LISTA E PAGAVE 1, LISTA E PAGAVE 2, VËRTETIMI dhe Libreza e punës, të parashtruar nga ankuesi argumentojnë faktin se i njëjti ka qenë punëtor i NSH gjer me datën e privatizimit, respektivisht 11 korrik 2007.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankuesit, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankuesit do ti mohojë e drejta në kompensimin e pagave.

AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart kanë dëshmuar vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankuesit. Kjo shihet nga fakti se AKP, ne Vendimin e saj mbi refuzimin e kërkesës si dhe përgjigjen ndaj ankuesit, e potencon vetëm se çështjen e së drejtës së tij mbi pagat si dhe çështjen e parashkrimit.

Në anën tjetër LISTA E PAGAVE 1 dhe LISTA E PAGAVE 2, dëshmojnë obligimin në paga ndaj ankuesit.

Nga gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesja ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit

NJOFTIMI, LISTA E PAGAVE 1, LISTA E PAGAVE 2, VËRTETIMI tregojnë faktin se ankuesi ishte i punësuar pranë NSH gjer me datën e privatizimit të saj.

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim.

Lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikës 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Së pari, duke u nisur mbi parimet e përgjithshme mbi parashkrimin të aplikuara dhe referuar sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare RSFJ nr. 29/78 me plotësime dhe ndryshime 39/85, 45/89, 31/93), dhe duke konsideruar se kërkesa është e natyrës kreditore, në nenin 370 thuhet, citat:

“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitë identike parashihet edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 351) dispozitë ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Sipas dispozitave të lartë cekura AKP me vet faktin e njoftimit me shkrim ndaj ankuesit për obligime nga marrëdhënia e punës konsiderohet se ka hequr dorë nga parashkrimi.

Tutje, rregullat për parashkrimin nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankuesit, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si

procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventuale, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartë cekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (lex specialis).

Asnjë punëtor apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksat gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000.00 €.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar